



Planuar / Dërguar Punë/Procedurë Received/Delivered	23-06-2021	vit god year	
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Rr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHI	3287/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.410/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtar, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.410/2021 të datës 11.05.2021 të parashtruar nga ankuesit

dhe të cilët me autorizim i përfaqëson me adresë Rr. "Mramori", Hajvali/Prishtinë, kundër organit të punësimit/Komunës së Shtimes, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 23.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.410/2021 e datës 11.05.2021 e parashtruar nga grup ankuesish të cilët me autorizim i përfaqëson Avokati

A r s y e t i m

Ankuesit, dhe që të gjithë të punësuar në Komunën e Shtimes, me datë 11.05.2021 përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit , kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 2324/2021 të regjistruar me numër A.nr.410/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtave ditore, për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018, sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 19.05.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Shtimes. Këshilli, me datë 01.06.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2324/2021 të regjistruar me numër A.nr.410/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e datës 11.05.2021; Autorizimin e datës 22.03.2021 për ankuesit

Përgjigjen në kërkesë të datës 12.03.2021 nga Komisioni Komunal për Shqyrtimin e Ankesave për Nëpunësit Publikë; Kërkesën për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Shtimes të datës 06.04.2021; Lista e pagës për periudhën 01-31 dhjetor 2018 për ankuesin

Vërtetimin e datës 12.03.2021 për ankuesin Vërtetimin e datës 12.03.2021 për ankuesin me numër 02/1Nr.133; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit për ankuesin

Lista e pagës për periudhën 01-31 dhjetor 2018 për ankuesin Vërtetimin e datës 25.02.2021 për ankuesin me numër 25.02.2021 për ankuesin Vërtetimin e datës 12.03.2021 për ankuesin me numër

02/1Nr.133; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit për ankuesin Lista e pagës për periudhën 01-31 dhjetor 2018 për ankuesin Vërtetimin e datës 25.02.2021 për ankuesin

Vërtetimin e datës 26.02.2021 për ankuesin me numër 02/1Nr.72; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit për ankuesin

26.02.2021 për ankuesin Vërtetimin e datës 26.02.2021 për ankuesin Vërtetimin e datës 26.02.2021 për ankuesin me numër 02/1Nr.70; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit për ankuesin

26.02.2021 për ankuesin Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.05.2021; Përgjigjen në kërkesë e datës 01.06.2021; Shkresën e datës 24.05.2021 me numër 02/1-196; -mailin e datës 24.05.2021 dërguar nga

për

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesit dhe organi i punësimi, ka konstatuar se ankesa e ankuesve, **është e pa bazuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, është konstatuar se të gjithë ankuesit janë të punësuar në Komunën e Shtimes.

Ankuesit më datë 06.04.2021, kanë parashtruar kërkesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Shtime, për kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtës ditore për ditët e pranisë në punë sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive për periudhën nga 01.01.2015 deri 31.12.2018. Ndërsa në përgjigje të kërkesës, Komisioni Komunal për Shqyrtimin e Ankesave për Nëpunësit Publikë, me atë 23.04.2021, ka njoftuar përfaqësuesin e autorizuar të ankuesve se sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nëpunësit civil paraqesin ankesë drejtpërdrejtë në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil.

Pas këtij njoftimi, ankuesit, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 11.05.2021 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e pagave jubilarë dhe shujtave ditore, për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018, sipas Kontratës së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesve dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhë jo më shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.



Bazuar në këtë konstatim, dhe në kuptim të nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, Kolegji konstaton se kërkesa e ankuesve për realizimin e kompensimit të pagave jubilarë dhe shujtave ditore për vitin 2015, 2016, dhe 2017 është parashkruar, kështu që pretendimi ankimor i ankuesve mbi këtë bazë ligjore është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.410/2021

Elakron GASHI

Zyrtar i Lartë për *Bashkëpunim Profesional*



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve Avokat
- Kryetarit të Komunës së Shtimes;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Shtimes; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

